

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9426, DATË 06. 10. 2005 “PËR MBARËSHTIMIN E
BLEGTORISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Në kuadër të reformës së derregullimit dhe me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26. 05. 2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, ndër të tjera u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen. Me anë të këtyre ndryshimeve, synohet të arrihet: (a) Reduktim i barrierave administrative; (b) Liberalizim i tregut; dhe (c) Përmirësim i mëtejshëm i klimës së biznesit

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projekt vendimi nuk është i planifikuar, në programin analitik të projekt akteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Neni 5, i Ligjit Nr. 10081, datë 23/02/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se *“Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj, ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.”*

Përsa më sipër, me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimitarisë së ndërzimit natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror) do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk përfron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

VI. PËRMbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së ndërzimit natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror) do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

NIKO PELESHI

**MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ARBEN AHMETAJ